



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 132 / Prot. 13

Vlorë më, 25.01.2024

VENDIM
Nr. 7, datë 25.01.2024

PËR
NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR.3 TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT, DATË
19.01.2024 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË
BURSË PËRJASHTIM DHE REDUKTIM NGA TARIFA"

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në VKM nr. 39, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, të ndryshuar", VKM nr. 40, datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar si dhe referuar propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ardhur me shkresën nr. 141/3, prot, datë 25.01.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 25.01.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin për një saktësim në vendimin nr.3 të Bordit të Administrimit, datë 19.01.2024 duke përjashtuar nga bursa studentët sipas tabelës më poshtë:

Bursa	Dega e studimit	Vlera e Burses/Lekë
Polikseni Leonard Mone	MSC Biologji	70,000
Lindi Besnik Zahaj	MSC Shk.kompjuterike	60,000

2. Arsyeja e këtij përjashtimi është se studentët e sipërpërmendur janë studentë të Ciklit të dytë të studimeve dhe kjo bie në kundërshtim me VKM nr.39, datë 23.01.2019, pika 12.
3. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Zv. Rektorit Akademik dhe Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Sotir NIKOLLA

